



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr. 03-250**  
**20.07.2023**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 и 77/21), dhe në lidhje me nenin 14 të Ligjit për Mediat („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13 dhe 13/14), pika 16 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacioneve të disponueshme për përdoruesit, ark.nr.01-4443/1 datë 9.10.2018, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-2548/1 datë 20.6.2023 dhe Konkluzionin nr.02-2865/5 datë 20.7.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 23-të mbajtur më 19.7.2023, miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, për shkelje të kryer nga neni 14 nga Ligji për Mediat (LM), në mënyrë që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor në radio, transmetuar më 2.6.2023, në emisionin „Praznično so Angella“(Festive me Angellën), nuk ka publikuar të dhënat që është i obliguar t'i transmeton në vendin e caktuar (duhur) për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr. 10-2548/1 datë 20.6.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LM.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

**A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 29 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe neni 29 nga Ligji për Mediat (LM), është kompetente të kryen mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave në aspekt të harmonizimit të punës së tyre me detyrimet nga nenet 6, 8, 14 dhe 15 nga LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – aktvendim për vërejtje publike në pajtueshmëri me këtë Ligj, në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar nga Ligji i njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) nga LM, masat që Agjencia si trup rregullator kompetent mund t'i ndërmarrë, të cilat janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen përkatësisht dhe në raste të shkeljes së dispozitave nga LM.

Sipas nenit 14 të LM, botuesi i medias obligohet në vendin e duhur për çdo bartës individual të përmbajtjes (psh.ekzemplar të medias së shkruar dhe emisioni televiziv) të ofron publikim të dhënave vijuese: emri dhe adresa e selisë dhe redaksisë së botuesit të medias, emri i personit përgjegjës të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës, gjegjësisht redaktorëve në pajtueshmëri me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emri dhe adresa e shtypshkronjës dhe datën e botimit ose ribotimit, numrin e kopjeve të botura, kur kemi të bëjmë me media botuese. Për transmetuesin detyrimi i lartpërmendur zbatohet në atë mënyrë që të dhënat publikohen në fillim dhe në fund të programeve audio/audiovizive. Botuesi i medias është i detyruar që në vend të përshtatshëm(caktuar) për çdo përmbajtje të publikon të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri i autorit të shtojcës së publikuar, emri dhe mbiemri i personit, gjegjësisht firmës që bart të drejtën autoriale për përmbajtjet e publikuara, përveç në median e shkruar dhe programeve në radio, datën e produksionit (muaji dhe viti) kur bëhet fjalë për vepra audio/audiovizive, origjina e veprave audio/audiovizive, dhe nëse vepra është prodhuar nga produksion i pavarur dhe informacion për të, emrin e personit, gjegjësisht emrin dhe mbiemrin e personit që e ruan të mirën kulturore të shfrytëzuar ose vepër arkivore, përkatësisht reproduksionin përkatës dhe emrin e botuesit të medias nga i cili është marrë shtojca programore ose pjesë nga shtojca programore, përveç nëse me marrëveshje të ndërsjelltë nuk është rregulluar ndryshe.

Në pajtim me pikën 16 të Udhëzimit për plotësim të detyrimeve për impresium dhe informacioneve të disponueshme për shfrytëzuesit, ark.nr.01-4443/1 datë 9.10.2018, në programet e tjera me prodhim vendor, impresiumi publikohet kështu: 1) në shpicën hyrëse dhe dalëse publikohen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të shërbimit programor; emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të redaksisë nga ku burom programi (nëse ka); emri dhe mbiemri i redaktorit/autorit/prezantuesit (moderatorit) të emisionit; emri dhe mbiemri i kant-autorëve, respektivisht të të gjithë ekipit pjesëmarrës në radio të veprës audio; datën e produksionit (muaj dhe viti), 2) nëse është e zbatueshme, duhet të publikohen dhe të dhënat për: emrin e personit juridik, respektivisht emrin dhe mbiemrin e personit që ruan të mirën kulturore të shfrytëzuar ose veprën e arkivuar, respektivisht reproduksionin e veprës; dhe emrin e subjekti tjetër nga ku është marrë shtojca e caktuar ose pjesë e shtojcës, përveç nëse me marrëveshje të ndërsjelltë nuk është rregulluar ndryshe.

Në kuadër të kompetencave Ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 20.6.2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor të SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, transmetuar më 2.6.2023, nga ku konstatoi shkelje të nenit 14 nga LM. Gjegjësisht, nga mbikëqyrja është konstatuar se në pjesë të shërbimit programor të transmetuesit, emetuar më 2.6.2023, nuk janë publikuar të dhënat me të cilat: identifikohen autorët pjesëmarrës në përgatitjen e përmbajtjeve audio, për bartësit e të drejtave autoriale, për redaktorin përgjegjës/ redaktorët e programeve, për origjinën dhe datën e produksionit të veprave audio, emrin e medias nga ku është marrë përmbajtja etj, që transmetuesi është i detyruar t'i emeton në vendin e caktuar (duhur) për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Në kundërshtim me pikën 16 të Udhëzimit për plotësimin e detyrimeve për impresium dhe informacioneve të disponueshme për shfrytëzuesit, në emisionin „Festive me Angellën“, as në shpicën hyrëse dhe as në shpicën dalëse nuk janë publikuar të dhënat për impresium – autoriale, stafin realizues, të dhënat për redaksinë dhe për datën e produksionit.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-2548/1 datë 20.6.2023, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtueshmëri me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, më 23.6.2023, dërgoi Shkresë me Nr.y në ark.10-2548/2 datë 23.6.2023 me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-2548/1 datë 20.6.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit, për këtë SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM, Nr.y në ark.10-2549/3 datë 12.7.2023. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 19.7.2023, pasi shqyrtoi

lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën me shkrim, konkludoi se ndaj SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip t'i shqiptoi masë – paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më lartë, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 të LM, pika 16 të Udhëzimit për plotësimin e detyrimeve për impresium dhe informacioneve të disponueshme për shfrytëzuesit, ark.nr.01-4443/1 datë 9.10.2018, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.10-2548/1 datë 20.6.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2865/5 datë 20.7.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 19.7.2023, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LM. Pas skadimit të afatit, përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit..

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit admnistativ para gjykatëskompetetnte. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor aktvendim si në dispozitiv.

**Shtojcë (1):**

1) Raport me shkrim përmbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-2548/1 datë 20.6.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës komtente. Padia për ngritjen e kontestit administativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit.